

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TIRANE



DREJTORIA E PERGJITHSHME E PUNEVE PUBLIKE

MIRATOI:
ERION VELIAJ
KRYETAR

Vkt. nr. _____ Data: __/__/2019

RELACION TEKNIK

***STUDIM PROJEKTIM, RIKONSTRUKSION I RRUGES
“GRIGOR CILKA“***

PROJEKT – ZBATIM

B.O.E “A.SH. Engineering” sh.p.k & “I.T.M.” sh.p.k

Tiranë, 2019

RELACION TEKNIK **I -Pershkrim i Pergjithshem .**

Bashkia Tirane kerkon realizimin e studim-projektimit gjer ne fazen e projekt – zbatimit te objektit: Rikonstruksion i rruges “Grigor Cilka” Njesia Administrative Nr. 2 te qytetit te Tiranës.

Rruga ndodhet ne pjesen juglindore te Tiranës , gjatesia e rruges eshte rreth 1100 m dhe shtrihet ne nje zone informale me ndertime te pas viteve 90'. Eshte nje nga degezimet e rruges “Shefqet Ndroqi”.

Objektivi I projektit do jete : Sistemimi I rruges me te gjithë elementet e infrastruktures rrugore me qellim permiresimin e cilesise se jeteses se komunitetit te kesaj zone dhe nderlidhjes me te mire me periferine e qytetit .

Kerkohe sipas detyres se projektimit :

- Rruge me dy kalime me keto parametra :
 - a) Pjesa kaluese 2 x 2.5 m, kuneta 2 x 0.5 m, trotuare minimum 2 x 0.5 m (trotuaret mund te parashikohen variable sipas kushteve konkrete qe na dalin gjate studimit)
 - b) Muret rrethues te rinj, ne zonat te cilat duhen prishur ,
Pjesa e rrethimit mbi rruge te projektohet sipas detajit te miratuar nga bashkia Tirane.
 - c) Shtresat rrugore te projektuara ne perputhje me standartet, qe parashikon ne kushtet teknike te projektimit. Perlllogaritja e shtresave rrugore te behet duke marre parasysh tre faktoret kryesor :
- Trafikun (numrin kumulativ ekuivalent)
- Fortesine e tabanit te rruges duke marre ne konsiderate CBR (kapaciteti mbajtes kalifornian)
- Cilesine e materialeve te shtresave
 - d) Marrjen e gjithë masave inxhinierike per te patur nje rruge te qendrueshme, me mure mbajtes e prites , rrjet kanalizimesh te ujrave te zeza dhe te bardha , telefoni , ndricim rrugor , sinjalistike rrugore sa me funksionale.

Gjate hartimit te projektit te rruges ne te gjitha fazat kemi pasur parasysh :

- Kryerjen e studimit te projektit te rruges duke u bazuar ne “ Kushtet teknike te projektimit te rrugeve ne perputhje me “Manualin Shqiptar te Projektimit te Rrugeve MShPRr , vitit 2015” I cili permban modul MShPRr-2, qe perfshin Projektimin gjeo,etrik te rrugeve . Shtojme ketu se prerja terthore e rruges eshte diktuar ne detyren e projektimit si vijon :
- Dy kalime 2 x 2.5m + 2 x 0.5m kunete + 2 x 0.5m trotuar (0.2bordura+0.3trotuar)
- Studimin topografik te zones
 - Numrin e mjeteve te transportit per periudhen e ndertimit dhe sherbimit.
 - Perdorimin e materialeve rrethanore ne ndertimin e rruges.
 - Rrjetin inxhinierik qe do te kaloje ne gjeresine e trupit te rruges si rrjeti i furnizimit me energji , rrjeti i ndricimit , rrjeti i kanalizimeve te ujrave te bardha dhe te zeza , nderhyrjet e rrjetit me trupin e rruges , vleresimi i rrjeteve ekzistues , ndertimi i rrjeteve te reja shtese.
 - Masat mbrojtese qe do te merren per mjedisin (sidomos per fazen e ndertimit)
 - Masat per sigurimin e levizjes se njerezve dhe mjeteve.

II - Gjendja e Rrugeve Ekzistuese

a) Paraqitje planimetrice

Si rezultat i zhvillimit te zones pa studime urbanistike , pjesore apo gjenerale dhe pa parashikime ne kohe per perspektiven kemi nje realitet me mjaft probleme per te realizuar rrugen sipas standarteve dhe kerkesave qe parashtron detyra e projektimit . Disa nga fotot ku pasqyrohet gjendja ekzistuese:





Vete kufizimi ne detyren e projektimit ne pjesen kaluese 2 x 2.5 m , ku minimumi 2 kalime duhen 2 x 2.75 m per zonat urbane sipas normave italiane te projektimit, kufizimi ne trotuare , tregon se jemi para nje realiteti qe ne disa drejtime te pakorrigjueshme.

Gjeresia e rruges ekzistuese varion nga 4 m ne 7 m .

Shtresat rrugore pothuajse te shkaterruara , shtresat asfaltike nuk ekzistojne.

Ka mure rrethues nga te dyja anet te ndertuara pa kriter .

Mungojne trotuaret dhe mungon totalisht orientimi i ujrave te shiut ne kanalizime.

Ka mungese ne disa zona te kanalizimeve te ujrave te zeza , por edhe atje ku jane bere disa investime ka probleme te cilat kerkojne nderhyrje per tu kthyer ne eficente.

Eshte ndertuar rrjeti i ujesjellesit ne disa zona, por ne rruge vihen re gjurma uji qe jane pasoje e difekteve qe ka ky rrjet, ndaj kerkon nderhyrje para rikonstruksionit te rruges.

Rruga eshte konceptuar dhe trajtuar me dy akse A dhe B.


Zona me problematike mbetet zona e aksit B, referuar planimetrise nga seksioni 2 sipas progresivit deri ne seksionin 18 me nje gjatesi 400 ml.

Eshte zone ku ndertimet jane zhvilluar ne shpat me pjerresi.


Ne studimin gjeologjik:

- U kryen 6 shpime me thellesi 10 m ne vendet me problematike. Jane marre kampione, dhe mbi bazen e analizave laboratorike jane percaktuar parametrat fiziko-mekanike te cdo shtrese.

- Jane hartuar prerjet terthore gjeologjike per cdo shpim ku percaktohen 4 shtresa dhe thellesite e tyre. Llojet e shtresave jane:




Dhera te hedhura dhe toka vegetale, perbehen nga suargjila te mesme, me ngjyre kafe, me lageshti, plastike. Permbajne guricka dhe rrenje bimesh. Jane pak te ngjeshura.



Suargjila te mesme deri te renda, me ngjyre kafe ne bezhe, me lageshti, plastike, permbajne coparanori. Jane mesatarisht te ngjeshura.



Argjilite, alevrolite, ranore, me ngjyre bezh ne gri, me pak lageshti, me cemento te dobet me carje. Jane te ngjeshura.



Argjilite, alevrolite dhe ranore, me ngjyre gri, me pak lageshti, me cimentim mesatar deri te mire, me carje. Jane shume te ngjeshura.

- Sipas prerjeve gjeologjike thellesia e shtreses 2 varion nga 3.2 ne 6.6m, ndersa rrenjesori (shtresa 3,4) nen kete thellesi.
- Kjo situatë kerkon nderhyrje te studjuara.
Kur nderhyrja behet e pa studjuar provokojme rreshqitje . Marrja paraprake e masave inxhinierike i eviton ato.
- Nje pjese jo e vogel e mureve prites te ndertuar mbi rruge , krijimi i shesheve para objekteve e rendon situaten , cenon qendrueshmerine e shpatit.
- Krijimi i shesheve te ndertimit nen rruge provokon rreshqitje .
- Nje pjese e mire e mureve prites mbi rruge jane te demtuar , kane plasaritje , humbje te vertikaltetit , carje etj.

Ne muret prites ne pjesen mbi rruge disa mure prishen per zgjerimin e rruges, por theksojme qe jane njekohesisht me probleme ne qendrueshmeri. Ne pjesen posht rruges, ku ka zona te lira, do ndertohen mure mbajtes ne funksion te qendrueshmerise se rruges. Ndertimi i banesave ne perspektive duhet te behet me projekte te studjuara dhe me cdo kusht me leje ndertimi nga Bashkia.



Mur prites i rrezuar



Shpat i pjerret ana e poshtme kerkon masa inxhinierike, per qendrueshmerine e rruges

b) Paraqitja altimetrike

Duke iu referuar profilit gjatesor te rruges ka zona me pjerresi te madhe si vijon :

- Ne aksin A :
- Nga piketa 1 – 8 (gjatesia 60m) pjerresia rezulton 19 %
- Ne aksin B
- Nga piketa 19 – 20 (gjatesia 30 ml) pjerresia rezulton 14.6 %
 - Nga piketa 24 – 27 (gjatesia 75 ml) pjerrsia rezulton 19 % ; 15.8 %

III - HARTIMI I PROJEKT IDESE (Miratimi i variantit perfundimtar.)

U hartua projekt-idea ne 3 variante :

➤ Varianti i pare

Parashikoi rikonstrukcionin e rruges sipas kerkesave te parashtruara ne detyren e projektimit me ndonje devijim ne pamundesi si vijon:

- Pjesa kaluese 2 x 2.5 m; kuneta 2 x 0.5 m; trotualet 2 x 0.5 m (minimumi) dhe variable.
- Pjerrtesia gjatesore ne pjesen me te madhe te gjatesise te rruges ploteson parametrat e kerkuara. Por me gjithe tentativat , ne disa segmente keto pjerrtesi vetem u permiresuan si vijon:

Aksi A :

Nga piketa 1 – 8

- Pjerrtesia nga 19% u arrit ne 15.4%

Aksi B :

Nga piketa 19 - 20

- Pjerrtesia nga 14% ne 12.1%.

Nga piketa 24 – 27

- Pjerrtesia permiresohet nga 19% ne 15.8% dhe 15.3%.

Varianti i pare kushton: 115_550_452.11 me TVSH

➤ Varianti i dyte

Varianti i dyte ndryshon nga varianti i pare mbasi rruget ne aksin B nga piketa 2 – 13 eshte projektuar me seksion te reduktuar nga 7 m minimum mur rrethues – mur rrethues ne 6.2 m. Gjithashtu rruga eshte projektuar me nje pjerrtesi terthore. Keshtu parametrat e rruges behen:

- Trotuar 1 x 0.5 m, pjese kaluese 2 x 2.5 m, kunete 1 x 0.5 m, bordur 0.2 m.

Ky dizavantazh kufizon levizjen e mjeteve (shpejtesine), levizjen e njerezve, por krijon keto avantazhe:

Lehteson disi masat inxhinjerike, sidomos ne ndertimin e mureve prites, zvogelon disi prishjet e mureve rrethues, zvogelon masen e siperfaqeve te shpronosimeev ne kete zone te banuar, lehteson prolemet sociale dhe ulur disi koston e ndertimit.

Varianti i dyte kushton: 105_417_866.50 me TVSH

➤ Varianti i trete

Sipas ketij varianti paketa e shtresave rrugore ndryshon ne pjeset per pjerresi mbi 12% konkretisht ne zonat:

- aksi "A" nga piketa 1-8 (gjatesia 60m pjerrtesia 15.4%),
- aksi "B" nga pikat 19-20 (gjatesia 30m pjerrtesia 12.1%)
nga piketa 24-27 (gjatesi 75m dhe pjerrtesia 14.3% dhe 15.3%)

Keshtu shtresa asfaltike (binder 6cm dhe asfaltobeton 4cm) zevendesohet me shtrese b/a me beton C25/30. Siperfaqja e rruges trajtohet e ashper gjate betonimit (kruarje e siperfaqes me fshese hekuri).

Sipas ketij varianti :

- Realizohet rruge cilesore , e pershtatshme per levizjen e mjeteve,
- Zvogelon demtimet gjate perdorimit te rruges,
- Lehtesohet largimi i ujerave siperfaqesore.
- Ka jetegjatesi me te madhe.
- Kosto e ndertimit rritet.

Konkluzion:

Ne mbledhjen e keshillit Teknik te Bashkise dt. 10/10/2018 u vendos:

- Miratimi I variantit te trete, pra variant i pare me ndryshimin qe ne zonat e rruges me pjerrtesi mbi 12% shtresat asfaltike zevendesohen me shtrese b/a me beton C25/30 dhe t = 22cm.

Varianti i trete kushton: 117.575.345.45 me TVSH

U miratua variant i trete edhe pse kushton me shume per vete avantazhet qe ka ky variant.

IV – Projekt Zbatimi

U hartua ne perputhje me variantin e miratuar nga keshilli Teknik i Bashkise dt. 10.10.2018 dhe konkretisht sipas variantit te pare kombinuar me variantin e trete te realizuar ne fazen e projekt – idese.

Grupi i projektimit ne kete faze ka patur parasysh:

- Te gjitha kerkesat qe parashtrihen ne detyren e projektimit, per te realizuar rrugen me dy kalime ne perputhje me te gjitha normat dhe standartet qe parashikon legjistacioni ne fuqi, duke marre ne konsiderate dhe parashikimet ne perspektive per zhvillimin e zones ku ndertohet rruga .
- Riazhornimin e detajuar te rrjetit inxhinjrik egzistues si rrjeti i ujesjellesit, kanalizimeve, plotesimi dhe permiresimi i tyre per te vene ne funksion te plote dhe per te mos pasur pasoja ne jetegjatesine e rruges.
- Plotesimin e studimit paraprak gjeologjik hartuar ne fazen e projekt – idese duke kryer shpime dhe analiza ne zonat me problematike.
- Studimin e plote ne percaktimin e masave inxhinjrike per sigurimin e qendrueshmerise se rruges qe rikonstruktjme, duke perdorur zgjidhje sa me efikase per stabilizimin e shpatit.

- Njohjen dhe përdorimin e gjithë detajeve teknike të sukseshme të zbatuara në projektet e mëparshme.
- Hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit Teknik me standarte duke përdorur programe kompjuterike sa më të avancuar.

U miratua prerja terthore tip sipas detyres së projektimit rrugë me gjeresi minimum 7 m si vijon :

- Pjesa kaluese 2 x 2.5 m
- Kuneta b/a 2 x 0.5 m
- Trotuar minimum 2 x 0.5 m (0.2m gjeresi bordure , 0.3m shtrese me pllaka)

Ne aksin A (ku gjendja ekzistuese e rruges lejon zgjerim trotuari) u miratua

- Pjesa kaluese 2 x 2.5 m
- Kuneta b/a 2 x 0.5 m
- Trotuar 2 x (deri në 1 m) në të dy anët sipas vendit (0.2m bordur +0.8m pllaka)

Ne aksin B afërsisht deri në piketen 22 u miratua rruga si vijon :

- Pjesa kaluese 2 x 2.5 m
- Kuneta b/a 2 x 0.5 m
- Trotuar 2 x 0.5m në njërin anë dhe 2 x 0.7m në anën tjetër (ku në të dyja rastet 0.2m bordur + pjesa respektive me pllaka)

Gjate hartimit dhe projektimit në këto faze u kryen këto llogaritje konstruktive:

- Llogaritjet për shtresat rrugore.*
- Llogaritjet e mureve mbajtës , prites dhe mureve rrethues.*
- Llogaritja e mureve mbajtës e prites me pilota.*

A) LLOGARITJA E SHTRESAVE RRUGORE

A. Të përgjithshme

Llogaritja e shtresave rrugore për rikonstrukcionin e rruges “Grigor Cilka” është kryer sipas “METODËS AASHTO” bazur në literaturën bashkohore si libëri : ***AASHTO GUIDE for Design of Pavement Structures viti***, si dhe suplementet që kanë dalë në vitet në vazhdim.

Është patur parasysh koncepti bazë në projektimin e shtresave rrugore me mbulesë fleksibël, ku llogaritja kryhet me teorinë e elasticitetit dhe ku merren në konsideratë vetëm deformacionet elastike (në këtë rast procedojmë vetëm me modulet e elasticitetit). Treguesi CBR është më pranë këtij moduli, ku për tabanin kemi vartësinë $M_r (\text{ksi}) = 1.5 \text{ CBR} (\%)$
Në llogaritjet e trafikut dhe përcaktimin e shumatoreve të ngarkesave aksore standart për periudhën 20 vjet ESAL (18 kip) në bazë të një metodike kemi shfrytëzuar:

- Volumet e punimeve që do kryhen për rikonstrukcionin sipas preventivit (projekt – idese), si dhe kohën e realizimit të rruges sipas planit kalendarik të punimeve (Grafikut).
- Makineritë dhe mekanizmat që do përdoren sipas plan – organizimit në periudhën e ndërtimit.
- Matje manuale ditore të trafikut, në disa javë dhe disa të dhëna paraprake të grumbulluar për përcaktimin e trafikut për periudhën e shfrytëzimit (20 vjet, etj).

B. Teori mbi llogaritjet

Përvoja ka treguar nga krahasimi i disa metodave për projektimin e shtresave rrugore (metodat empirike tabelore apo metodat e deformacionit), se llogaritja sipas AASHTO-së është më e përshtatshme për Shqipërinë dhe përdoret për përcaktimin e trashësisë së shtresave.

Vlefshmëria e materialeve lokale të ndërtimit, si edhe kërkesat për mirëmbajtje të ardhshme merren parasysh në zgjedhjen e tipit dhe trashësisë së shtresave.

Për projektimin e shtresave rrugore marrim parasysh tre faktorë kryesorë:

- Trafiku
- Fortësia e tabanit të rrugës
- Materialet e shtresave

a) Trafiku shprehet me terma të numrit kumulativ ekuivalent të akseve standart dhe kërkon njohjen e parametrave të mëposhtëm:

- Fluksi aktual i automjeteve tregëtare.
- Rritja e ardhshme e trafikut të mjeteve tregëtare.
- Shpërndarja e ngarkesës aksore të mjeteve tregëtare gjatë shfrytëzimit të rrugëve.

b) Fortësia e tabanit të rrugës

Vlerësimet për tabanin e rrugës përcaktohen në studimin gjeologjik të kryer në gjithë gjatësinë e rrugës. Në rastin e rruges që rikonstruktohet treguesi C.B.R për tabanin e rruges

Koeficienti	Vlera	Kur perdoret
-------------	-------	--------------

sipas studimit na jepet 2 ; 2.5 deri 3%.

c) Materialet e shtresave.

Cilësia e materialeve të shtresave merret në përputhje me specifikimet teknike. Mbi këtë bazë bëhet përzgjedhja e karrierve nga ku sigurohen materialet për rrugën.

Për llogaritjen sipas metodologjisë AASHTO duhet të kemi parasysh keto koncepte:

- Kapaciteti struktural.
- Treguesi CBR (kapaciteti mbajtës Kalifornian) që jepet në përqindje.

Kapaciteti struktural

Numri struktural është një numër abstrakt që shpreh fortësinë strukturale të shtresës dhe konvertohet me anën e koeficientave në trashësi, si në trashësi të shtresës qarkulluese, shtresës bazë granulare dhe nënshtresës.

$$\text{Numri struktural } SN = a_1D_1 + a_2D_2 + a_3D_3 + m_4a_4D_4$$

D₁- Trashësia e shtresës qarkulluese

D₂- Trashësia e shtresës bazë granulare

D₃- D₄ Trashësia e shtresës nën bazë

a₁, a₂, a₃, a₄ - janë koeficienta ku vlerat varen nga cilësitë e materialeve dhe jepen në tabelën 1.

Tabela 1.

a₁	0.44	Kur shtresa sipërfaqesore është perzierje asfaltbetoni e prodhuar në fabrike me stabilitet të lartë
	0.40	Per shtresën e binderit
	0.20	Kur shtresa sipërfaqesore është perzierje asfaltike e përgatitur në rrugë (me penetracion)
a₂	0.30	Shtresa baze është konglomerat bituminoz
	0.23	Shtresa baze është trajtuar me çimento (çimentim)
	0.15 – 0.30	Shtresa baze është trajtuar me gelqere
	0.14	Shtresa baze është trajtuar me gure të thyer
a₃ - a₄	0.11	Shtresa nenbaze: zhavorr, çakell, çakell mina, çakell natyral
	0.05 – 0.10	Shtresa nenbaze rere ose argjile ranore

Efekt i mundshëm i drenimit mbi shtresën qarkulluese, shtresën bazë apo shtresën e rrugës nuk merret parasysh.

Vlerat “m₄” rekomandohen në tabela në funksion të cilësisë së drenazhit dhe përqindjes së kohës, gjatë vitit kur mbulesa i nënshtrohet normalisht niveleve të lagështirës afër me ngopjen.

Në këtë projekt koha merret më e madhe se 25% dhe cilësia e drenazhit të mirë, prandaj nga tabela vlera m₄ = 1.

- Treguesi C.B.R

AASHTO pranon se shumë autoritete të rrugës nuk kanë pajisjet për kryerjen e provave të modulit të elasticitetit. Për këtë në mënyrën e llogaritjes së shtresave rrugore me metodën e ASSHTO-së, përdorim vlerat e CBR e modulit të elasticitetit, ku vetëm për tabanin ekziston një lidhje korelative që shprehet në formulën e mëposhtme.

$$M_r(\text{ksi}) = 1.5 \text{ CBR (ne \%)}$$

Theksojmë se moduli i elasticitetit është një karakteristikë themelore e çdo materiali të shtresave ose të tabanit. Moduli i elasticitetit i referohet sjelljes së materialeve në sforcim-deformim nën kushtet normale të shtrimit të shtresës.

Është e rëndësishme të theksohet se gjithsesi termi modul elasticiteti mund të aplikohet në çdo tip materiali, M_r e përdorur në udhëzuesin e projektimit AASHTO aplikohet vetëm në taban.

CBR në përqindje përcaktohen ekzaktesisht me prova laboratorike sipas një procedure. Me anë të saj gjykojmë nëse një bazament është i përshtatshëm ose jo p.sh:

- a) CBR 2-5% bazament shumë i dobët për rrugën
- b) CBR 5-8% bazament i dobët për rrugën
- c) CBR 8-20% bazament mesatar
- d) CBR 20-30% bazament shumë i mirë

Numri structural (kapaciteti mbajtes i rruges qe projektojme), percaktohet ose grafikisht ose sipas formule (ekuacionit nomograf) qe eshte ndertuar ky grafik (shih grafikun fig.1) bazuar ne dy te dhenat kryesore:

- Ne numrin kumativ te akseve standart te llogaritur nga trafiku per periudhen 20 vjet.
- Ne MR (Ksi).

LLOGARITJA TRAFIKUT PER PERIUDHEN E NDERTIMIT

Periudha e ndertimit, sipas grafikut eshte parashikuar 1 vit. (Bazuar ne volumet e punimeve dhe menyra e organizimit, mjetet dhe mekanizmat qe do perdoren).

Sipas plan organizimit, punimet do zhvillohen shkalle – shkalle sipas zonave. Rruga egzistuese do sherbeje si rruge kantjeri deri kur ne chdo zone te jene ndertuar muret prites, muret prites me pilota, themelet e mureve rrethues (nga ana e siperme, djathtas drejtimit nga kryqezimi me rrugen “Shefqet Ndroqi”), si dhe muret mbajtes, muret mbajtes me pilota, themelet e mureve rrethues nga ana e poshtme, majtas.

Ne fazen e dyte te shkallezimit te punimeve kryhen punimet e germimit te tabanit per shtresat rrugore. Fillimisht kryhen zona – zona germimet per tabanin si dhe nenshtresa me cakell mina. Kjo rruge do sherbeje si rruge kantjeri deri ne perfundimin e rikonstruksionit te rruges. Ne fazen e dyte volumet e punimeve qe do kryhen ne ton dhe mjetet dhe mekanizmat qe do perdoren jepen ne tabelen 2.

Tabela 2

Nr	Materialet	Njesi	Sasi	Pesha ton/m ³	Pesha ton	Koeficienti korigjues	Pesha totale ton	Mjetet e mekanizmat
1	Shtresa zhavorri, Shtresa rere	m ³	1120	2.2	2464	1.3	3203	Shtresa mjete te renda.
2	Bordura, beton per fiksime per bordure, beton nen pllaka	m ³	260	2.4	624	1.3	811	
3	Betone kuneta Betone shtresa Betone rrethim	m ³	700	2.4	1680	1.3	2184	Presa, autobetoniere, mjete ngritese.
4	Shtrese me pllaka	m ³	70	2.3	161	1.3	209	Mjete te mesme.
5	Mur tulle rrethimi	m ³	186	1.8	335	1.3	436	Mjete te mesme
6	Hekur 12etony kangjella	ton	50	-	-	1.3	65	Mjete te renda
7	Shtrese							Shtrese kalimi,

	stabilizanti	m ³	880	2.2	1936	1.3	2517	mjete te renda
8	Shtresa asfaltike	m ³	500	2.3	1150	1.3	1495	Shtrese kalimi, mjete te renda
9	Te ndryshme	ton	1800	-	-	1.3	2340	Mjete te lehta Mjete te mesme Mjete te renda
10	Shuma	ton					13260	

Bazuar ne pervojat e deritanishme tek ne ne ndertimin e rrugeve, perqindjen e mjeteve te transportit (per transport materialesh) e marrim:

- Mjete te lehta 3 – 6 Ton = 8%
- Mjete te mesme 6 – 12 Ton = 16%
- Mjete te renda > 12 Ton = 64%
- Mjete shume te renda (mbi 40 Ton) = 12%

PERIUDHA E KRYERJES SE PUNIMEVE TE MESIPERME 120 DITE.

$$\text{Mesatarja ditore} = \frac{13260}{120} \approx 110 \text{ ton ne dite.}$$

Pershkruajme rrugen ne 1 dite:

$$\text{Numri i kalimeve mjeteve te lehta} = \frac{110 \cdot 0.08}{6 \cdot 0.75} = 2$$

$$\text{Numri i kalimeve mjete te mesme} = \frac{110 \cdot 0.16}{12 \cdot 0.75} = 2$$

$$\text{Numri i kalimeve mjete te renda} = \frac{110 \cdot 0.64}{16 \cdot 0.75} = 4$$

$$\text{Numri i kalimeve mjete shume te renda} = \frac{110 \cdot 0.12}{40 \cdot 0.65} \approx 0.5$$

Makinerite kryesore qe nevojiten (per keto punime):

- Fadrome 1
- Rul 1
- Autovinc 1
- Shtruese 1
- Prese betoni 1

Per percaktimin e numrit kumulativ ekuivalent te akseve standart do perdorim faktoret mesatare te ekuivalences te percaktuara me matje disa ditore dhe 4 periudha te vitit ne disa akse rrugore te vendit tone me formulen:

$$\text{Faktori i ekuivalences (FE)} = \left(\frac{\text{ngarkesat aksore te matura ne kg}}{8160 \text{ kg}} \right)^{4.55}$$

“8160” eshte ngarkesa aksiale sipas AASHTO, ndersa ne vendin tone ngarkesa aksiale eshte 10ton (duke pjestuar me 8160 del nje numer me i madh “FE”, keshtu bejme nje pershtatje dhe perdorim grafikun sipas Fig.1 per percaktimin e numrit struktural SN). Pra faktoret mesatare te ekuivalences te nxjerra nga matjet ne terren ne disa akse te rendesishme rrugore ne vendin tone e bejne kete korrigjim.

Faktoret mesatare te ekuivalences qe do perdorim bazuar ne logjiken e mesiperme jane :

$$\text{Mjete transporti te lehta} = 0.22$$

Mjete transporti te mesme = 1.2
Mjete transporti te renda = 5.1
Mjete transporti shume te renda = 7.8

Faktori mesatar i ekuivalences eshte karakteristike e llojit te mjetit (i lehte , i mesem , i rende , shume i rende) , dhe per te nxjerre shumatoren e ngarkesave aksiale , shumezohet numri i kalimeve te mjetit ne nje drejtim ne nje korsi per nje periudhe te caktuar me FEM (koeficienti mesatar i ekuivalences) pra FEM eshte tregues i llojit te mjetit dhe influencon shume pak (e paperfillshme) nese eshte rruge kombetare apo rurale etj.

Bazuar ne keto faktore mesatare te ekuivalences, nxjerim shumatoren ekuivalent te akseve standart per periudhen 1 vjecare te ndertimit sipas tabelës 3.

Tabela 3

Shumatore akseve standart gjate periudhes 4 mujore gjate ndertimit.

Nr	Kategoria e mjeteve	Kalimi ne dite, drejtimi 1	F.M.E	Shumatorja e akseve standart ne dite	Dite	Shumatore akseve standart periudhe ndertimi
1	Mjete transporti te lehta	2	0.22	0.44	120	50
2	Mjete transporti te mesme	2	1.2	2.4	120	288
3	Mjete transporti te renda	4	5.1	20.4	120	2448
4	Mjete transporti shume te renda	0.5	7.8	3.6	120	432
5	Fadroma 1 cope	6	5.1	30.6	120	3672
6	Rul i madh 1 cope	6	5.1	30.6	30	918
7	Rul i vogel 1 cope	6	2	12	60	720
8	Shtruise 1 cope	3	5.1	15.3	30	459
9	Prese betoni 1 cope	2	5.1	10.2	30	306
10	Autovinc 1 cope	2	5.1	10.2	15	153
Shumatore e akseve standart qe pershkoni		Shuma 1:		105.14		9449

rrugen						
Shumatore akseve standart qe kalon ne rruge gjate periudhes 4 mujore ne sherbim per zonen.						
1	Mjete transporti te lehta "16"	16	0.22	3.52	120	422
2	Mjete transporti te mesme "8"	6	1.2	7.2	120	864
3	Mjete transporti te renda "2"	2	5.1	10.2	90	918
4	Mjete transporti shume te renda "1"	1	7.8	7.8	30	234
Shumatore akseve standart		Shuma 2:		36.22	120	2438
Shuma 1 + Shuma 2						11887

Pra shumatorja ekuivalent e akseve standart ne nje drejtim eshte ~ 0.118 milion (18kip ESAL) per periudhen 4 mujore te ndertimit qe kakon ne rrugen e shtuar vetem me cakell.

Percaktojme SN (sipas figures "1") bazuar ne te dhenat e meposhtme:

- Trafiku = 0.118 milion (18kip ESAL)
- MR = 2 x 1.5 = 3.75 ksi ose 3750 psi
- Besueshmeria R=80, e cila supozon se cdo e dhene eshte nen mesataren e saj.
- Humbja e nivelit te sherbimit te projektuar:

$$\Delta\text{psi} = P_0 - P_t = 4.2 - 2 = 2.2$$

$P_0 = 4.2$ per shtresa fleksibel , $P_t = 2$ (trafik i vogel)

ZR= -1282 (shmangia standarte e pergjithshme)

Nga ekuacioni:

$$\log_{10} 11800 = -1.28 * 0.45 + 9.36 * \log_{10} (SN+1) - 0.20 + \frac{\log_{10} \left[\frac{2}{4.2-1.5} \right]}{0.4 + \frac{1094}{(SN+1)^{5.19}}} + 2.32 \log_{10} * 4500 -$$

8.07

Nga zgjidhja e ekuacionit $SN \approx 1.9 \text{ inch} * 2.54 = 4.8$

Trashesia e shtreses cakell mina per te sherbyer rruga si rruge kantieri :

$$t = \frac{4.826}{0.11} = 43 \text{ cm}$$

Perfundimisht $t = 40 \text{ cm}$

Llogarisim shumatoren e akseve standart te mjeteve qe pershkruajne rruget per periudhen 20 vjecare pas mbarimit te rikonstruksionit .

Nuk disponojme te dhena mbi ecurine e trafikut ne kete rruge.

U kryen vetem disa matje manuale, gjate periudhes qe projektonim pikerisht me datat 24,25/9/2018; 11,12/10/2018 dhe 5,6/11/2018 dhe evidentuam nje mesatare ditore si vijon:

- Mjete transporti te lehta 2-6 Ton = 14 ne 1 drejtim
- Mjete transporti te mesme 6-12 Ton = 6 ne 1 drejtim
- Mjete transporti te renda mbi 12 Ton = 2 ne 1 drejtim
- Mjete shume te renda mbi 40 Ton = 3 mjete ne 6 dite ne 1 drejtim

Mjetet e vogla nuk u regjistruan, pasi nuk merren parasysh ne llogaritjen e shtresave.


Shumatoren e akseve standart por periudhen 20 vjet pas perfundimit te rikonstruksionit jepen ne tabelen 4 duke parashikuar rritje trafikut gjate viteve si vijon:

- Per 5 vitet e para rritje trafikut per cdo vit 5%
- Per 10 vitet e tjera rritja per vdo vit 4%
- Ne 5 vitet e fundit rritja per cdo vit 3%

Nga tabela 3 dhe 4 rezulton:

Shumatore e akseve standart per periudhen e ndertimit eshte 11887.

Shumatore e akseve standart per 20 vjet eshte 228929



Shuma totale: 240816

Percaktojme nga Grafiku numrin structural, sipas ketyre te dhenave:

$W_{18} \approx 0.24 \text{ milion}$

Grafikisht SN :

Per CBR – 3% SN= 3.25 inch x 2.54 = 8.255

Per CBR – 2.5% SN= 3.4 inch x 2.54 = 8.636

Per CBR – 2% SN= 3.55 inch x 2.54 = 9.017

Paketa e shtresave per rrugen:

- Shtrese asfalto beton 4cm $4 \times 0.44 = 1.76$
- Shtrese binder 6cm $6 \times 0.4 = 2.4$
- Shtrese stabilizanti 15cm $15 \times 0.14 = 2.1$
- Shtrese cakell mina 40cm $40 \times 0.11 = 4.4$

Totali: 10.66

Konkluzion :

Shtresat rrugore u llogariten ne dy faza :

1- Faza e pare (periudha 1 vjecare e ndertimit te rruges) , nenbaza (cakell mina) duhet te jete 40 cm per te siguruar qendrueshmerine e rruges

2- Faza e dyte e shfrytezimit llogaritur per nje periudhe 20 vjecare ku shtresa baze stabilizant del 15 cm (minimumi) dhe shtresat asfaltike 4cm asfalt dhe 6cm binder (minimale)per kete tip rruge.

Tabela 4 shumatore e akseve standart per 20 vjet

Viti	Mjete te lehta	Mjete te mesme	Mjete te renda	Mjete shume te renda	Shuma ditore aks standart	Shuma vjetrore (365 dite)	Shuma progresive
	15(mjete/dite)	7(mjete/dite)	2(mjete/dite)	1(mjef/dite)			
1	0.22	1.2	5.1	7.8	29.7	10841	10841
	Numri i akseve standart ne dite.						
	3.3	8.4	10.2	7.8			
2	3.35	8.45	10.25	7.85	29.9	10914	21755
	3.4	8.5	10.3	7.9			
	Rritja per cdo vit 5%						
3	3.45	8.55	10.35	7.95	30.1	11060	43801
	3.5	8.6	10.4	8			
	Rritja per cdo vit 4%						
4	3.54	8.64	10.44	8.04	30.66	11191	66124
	3.58	8.68	10.48	8.08			
	Rritja per cdo vit 4%						
5	3.62	8.72	10.52	8.12	30.98	11308	88681
	3.66	8.76	10.56	8.16			
	Rritja per cdo vit 4%						
6	3.7	8.8	10.6	8.2	31.3	11425	111472
	3.74	8.84	10.64	8.24			
	Rritja per cdo vit 3%						
7	3.78	8.88	10.68	8.28	31.46	11483	122954
	3.82	8.92	10.72	8.32			
	Rritja per cdo vit 3%						
8	3.86	8.96	10.76	8.36	31.78	11600	146095
	3.9	9	10.8	8.4			
	Rritja per cdo vit 3%						
9	3.94	9.04	10.84	8.44	32.26	11775	181245
	3.98	9.08	10.88	8.48			
	Rritja per cdo vit 3%						
10	4.02	9.12	10.92	8.52	32.58	11892	204970
	4.06	9.16	10.96	8.56			
	Rritja per cdo vit 3%						
11	4.1	9.2	11	8.6	32.9	12009	228929
	Rritja per cdo vit 3%						
	Rritja per cdo vit 3%						
Total shumatore e akseve standart (per 20 vjet)					32.9	12009	228929
					228929		

B) LLOGARITJET E MUREVE MBAJTES , PRITES DHE MUREVE RRETHUES.

Zgjerimi i rruges egzistuese ne parametrat qe kerkon detyra e projektimit, sidomos ne aksin "B" nga piketa "1" deri ne piketen "18", u shoqerua me masa inxhinjrike nga te dy anet, sidomos pjesa mbi rruge. Parashikohet prishje te mureve egzistues, jo vetem si rezultat i zgjerimit, por edhe demtimeve qe kane pesuar si rezultat i ndertimeve pa kriter dhe jashte parametrave teknike. Krijimi i shesheve para objekteve me mbushje duke perdorur mure, e theksuar ne pjesen mbi rruge, ka krijuar shqetesime te dukshme ne disa zona. Mbushjet pa kriter , pa shkallezime ulin qendrueshmerine e shpatave.

Studimi gjeologjik i kryer ne kete rruge duke kryer 6 shpime deri 10 m, krijon bindjen e plote se nderhyrjet per zgjerim kerkojne jo vetem mure te dimensioneve mesatarisht te larte ne shume zona, por dhe masa dhe skema organizative shume te studiuara, qe nese nuk merren parasysh, provokojne rreshqitje me shume pasoja ne qendrueshmerine e shpatit si dhe sigurine e punonjesve gjate ndertimit.

Shtresa 2 sipas studimit gjeologjik perfaqeson nje shtrese me suargjila te mesme deri ne te renda, me ngjyre kafe ne bezhe me lageshti plastike, permbajne kokra ranori. Jane mesatarisht te ngjeshura. Kjo shtrese ka trashesi qe varion nga 2.4m (thellesi 3.2m) deri ne trashesine 5.8m (thellesi 6.6m).

Shtresat 3.4 perfaqesohen nga Eluvioni i formacionit rrenjesor, perbehet nga argjilite ranore dhe alevrolite me cimentim te dobet dhe carje (shtresa 3), me cimentim mesatar dhe te mire (shtresa 4); jane shtresa te ngjeshura.

Me kete panorama gjeologjike ne bashkepunim me grupin studimor dhe rekomandimeve te dhena, ne nje pjese te mureve kemi perdorur si taban shtresen 2 ne thellesi. (Duke patur parasysh krahas qendrueshmerise edhe koston.).

Por ne disa zona , me pjesen mbi rruge dhe zonat e lira ne pjeset nen rruge, per te siguruar qendrueshmerine sit e rruges, shpatit dhe objekteve te ndertuara jemi te detyruar te perdorim pilota b/a.

Pilotat b/a te perdorura per zgjerimin mbi rruge zvogelojne punimet e germimit krahasuar me volume e medha kur ndertohen mure b/a. Kryerja e volumeve te medha krijon permassa per rreshqitje te paperballueshme ne moment dhe me rrezikshemeri per njerezit dhe vete qendrueshmerine e banesave te ndertyara.

Ne pjesen nen rruge me masat inxhinjrike te marra nga banoret qe kane kryer ndertime krijohet bindja e plote mbi domosdoshmerine e perdorimit te pilotave te shkurtera. Ka zona qe kane demtime te dukshme te rrethimit. P.sh. ne aksin "B" te rruges ne piketen 18, nderhyrja per ndertimin e baneses ka krijuar premisa te dukshme per rreshqitje. Ne zonat me demtime te dukshme kemi parashikuar masa inxhinjrike shtese.

Masat inxhinjrike, qe do te merren pasqyrohen ne vizatimet e punes te projekt – zbatim dhe konkretisht ne:

- Planimetrine e rruges ne Shk 1:200
- Ne prerjet terthore Shk 1:100
- Pamjen gjatesore ne Shk 1:100 (ose 1:200)

Ne muret rrethues nuk eshte perdorur themel i vazhduar , por bazamenti eshte realizuar me sistemin plinta – trare per keto arsye:

- *Per te arritur ne taban te qendrueshem (shtresa "1" 60-80 cm hiqet si e papershtatshme)*
- *Per pjerrtesite e medha ne nje pjese te konsiderueshme te rruges.*
- *Per disnivele ne disa zona te rruges ± 60 cm nivel trotuar – nivel sistemimi sheshi.*

Kjo skeme per muret rrethues eshte perdorur ne disa komplekse banimi, ne rruge me pjerrtessi te medha apo me taban te dobet. Skema siguron rrethim te qendrueshem, me kosto te arsyeshme. Pjesa mbi bazament eshte planifikuar detaji i rekomanduar nga Bashkia, mur tulle 25cm, mbi te vendosen kangjella (H=1m).

Muret mbajtes e prites jane disa tipe si vijon :

H= 1.1 + 0.3 m; H= 1.6 + 0.4 m; H= 2 + 0.4m; H= 2.5 + 0.4 m; H= 3 + 0.45 m; H= 3.5 + 0.45 m.

Te gjitha muret b/a te mesiperme jane projektuar me dhemb te vazhduar, per te perballuar rreshqitjet (perfshire dhe ne rast termeti).

Per llogaritjen e mureve mbajtes e prites kemi perdorur me kombinim keto skema llogaritese:

Skema 2

	$V = 45^\circ - \frac{\phi}{2}$	$E = \frac{\gamma h}{2} * (h + 2h_0) * \text{tg}^2(45 - \frac{\phi}{2})$	$Z = \frac{h}{3} * \frac{h + 3h_0}{h + 2h_0}$
--	---------------------------------	--	---

Skema 5


	$\text{tg}v = \frac{-\text{tg}\phi + \sqrt{\frac{\sec^2\phi - \frac{2\text{tg}\alpha}{\sin 2\phi}}{1 - \frac{2\text{tg}\alpha}{\sin 2\phi}}}}{\sin 2\phi}$ $V = 90 - \phi$	$E = \frac{\gamma h^2}{2} * \cos\alpha * \frac{\sin V}{\cos(V + \alpha) * \text{tg}(v + \phi)}$ $E = \frac{\gamma h^2}{2} * \cos^2\phi$	$E = \frac{h}{3}$ $Z = \frac{h}{3}$
